

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Leximi i numrave ose: mjerim opozitar!
ADRESA	https://www.gazetatema.net/blogu-tema/leximi-i-numrave-ose-mjerim-opozitar-i587276
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	20 shtator 2026, 13:32:04 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	20 shtator 2026, 13:30:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	0e33d4a4ad56160d3533b5e7374974fd7115944b46a231dd2d29be1fa188418f
TEKSTI	4ed0fc4a06e4bbe4fd8c0c9c8a91f69dfb0539f8e705a9ec777e87cc671c78e4
PAMJA	e60516816f6a8eea86988efab6dedcd940590c3cd048490052861035d4765c69

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	be4597810d55024513c3faf0d1ac9ec4b0f05dae7e3112a949fa3d89e889670c
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	9767af9aea99dbf2ca0400fc3d10892444ae0e1100c3c88a0d864d11255bea91
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/be4597810d55024513c3faf0d1ac9ec4b0f05dae7e3112a949fa3d89e889670c>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

 English

Built and Monetized by  [Kontakt](#)

 English

Leximi i numrave ose: mjerim opozitar! Reforma territoriale, te henen Komisioni i Ligjeve nis shqyrtimin e draftit te socialisteve SPA nxit remitancat. BSH: Ulja e kostove fundit

Leximi i numrave ose: mjerim opozitar!



20 Shtator 2026, 15:30 Blog Nga Hamdi Jupe

Para pak ditësh ndodhi debati dhe votimi në Kuvend për rrogat e gjykatësve dhe prokurorëve. Ka rëndësi të lexohet me kujdes ai votim. Shifrat e tij flasin shumë për atë që po ndodh sot në Shqipëri nga politika shqiptare, e pozitës dhe opozitës. Votimi në Kuvend doli me rezultat të qartë: 84 vota “pro” ligjit të propozuar nga qeveria dhe 27 vota kundër tij, vota këto të opozitës.

Dihet që qeveria ka vetëm 80 deputetë në Kuvend, pas largimit prej saj të “malësorës” që flet gjuhën e Lek Dukagjinit. Kater vota të tjera në mbështetje të qeverisë ishin nga subjekte të tjera politike jashtë saj. Pra nuk ishte vetëm Partia Socialisteve kundër maskarades së pagave të gjykatësve dhe prokurorëve.

Ky rezultat me vlera kushtetuese duhet t’i bente të mendoheshin paksa gjykatësit dhe prokurorët, që pretendojnë se po mbrojnë Kushtetutën dhe ligjet. Por ata “e moren frerin neper kembë” dhe thanë se do të vazhdojnë ende aventurën në kërkim të parave. Punë e tyre. Ne na duhet të vazhdojmë analizën politike, pra të shifrave të votimit në Kuvend.

“Pro” kërkesës së gjykatësve dhe prokurorëve për rritjen e rrogave votuan vetëm 27 deputetë të opozites. Shifër zyrtare kjo. Është e drejtë e tyre të votojnë ashtu siç e mendojnë, por është e drejta jonë të komentojmë shifrat. Kujtojmë se e gjithë opozita së bashku ka sot gjithsej 60 deputetë në Kuvend, duke përfshirë edhe “malesoren”.

Ku shkuan pra, 33 deputetët e tjerë të saj, që nuk votuan fare, ose nuk votuan sipas “urdhrit” të shefit të tyre parlamentar Gaz Bardhi, sipas vendimit të liderit të saj Sali Berisha? Pse u fshehën ata, 30 burra dhe gra, (përfshirë 4 “rrebelët” që votuan për variantin e qeverisë) dhe që përbëjnë rreth 55 përqind e deputetëve të opozites? Ca u fshehën pas kurrizit të grave/burrave të tyre në shtëpi, (se ishte ora 2 pas mesnate, kur u bë votimi) ca qëndruan në kafenenë plot tym duhani të Kuvendit dhe ca pas “abstenimeve” të tyre për ligjin, kur bëhej votimi për rrogat e “vobekta” të gjykatësve dhe prokurorëve.

Pse nuk votuan ata 30 deputetë të opozitës sipas urdhrit politik të liderit të tyre “historik”? Ky është një problem jo fort i vështirë për t’u kuptuar. Ata, deputetët e opozitës, nuk ishin dakord me rritjen stratosferike të rrogave të njerezve të ligjit, prandaj nuk votuan, i bene bisht votimit dhe ketu eshte problemi i “unitetit monolit” të partisë së tyre opozitare. Lideri i tyre Berisha u keput duke e quajtur SPAK-un nga mengjesi në mbremje “SKRAP” dhe të deklaroi se do ta shkrije ate sapo te vije ne pushtet. Ai u largua nga votimi se është moshë e vjetër dhe i vinte gjumë, duke ia lënë “veprën” e tij në dorë zotit Bardhi. Atehere, si mund të pranojë njeriu me mend në kokë këtë ndryshim 180 - gradësh të qëndrimit të tij ndaj prokurorëve dhe gjykatësve? Kjo është çështje e moralit të politikës së opozitës, domethënë: “bëni si them unë, por mos bëni si bëj unë”.

Nëse opozita do të ishte sot në pushtet, a do të votonte ajo “pro” ligjit për rritjen e rrogave të gjykatësve dhe prokurorëve? Natyrisht që jo, se pastaj nuk do të guxonte të shkonte më në popull për të kërkuar vota. Sondazhet publike të mediave tregojnë se rreth 75 përqind e qytetarëve ishin kundër marrëzisë së rrogave të larta të kërkuara prej tyre. Hall i madh si mund të shkojë në popull kjo parti e të kërkojë vota prej tij pas tetë muajsh për qeverisjen vendore, pas këtyre qëndrimeve të pamoralshme politike në Kuvend.

Ata nuk do të kishin kurajo të dilnin para popullit, kur ai t’i pyeste: pse votuat për ngritjen e rrogave të gjykatësve dhe prokurorëve, që na “kane pire gjakun” tash e 30 vjet etj. Mazhoranca i vuri në “rresht” të 80 deputetët e mbetur të saj, se për atë punë kanë shkuar në Kuvend dhe me rroga të mira. Opozites iu katandis kokoshi thelë. Ky është problemi: vetëm sepse projekt-ligjin e ka sjellë qeveria, prandaj të dalim kundër tij. Mjerim opozitar.

Perfundimi: nga 140 deputetë që ka Kuvendi, vetëm 27 prej tyre, ose gjithsej 19,3 përqind e gjithë deputeteve votuan “pro” gjykatësve dhe prokurorëve. Sa posht ka rënë opozita, edhe pas 13 vitesh qëndrimi në opozitë. Qëndrime eklektike që nuk e çojnë askund. Dhe zgjedhjet e reja lokale janë një në prag. Dhe alibia e opozitës për “manipulimin” e tyre është e gatshme në syrtar që nga zgjedhjet e kaluara.

 Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Pushteti e pret protestën si një serial televiziv: në të njëjtën orë, në të njëjtin vend, me të njëjtin repertor](#)

15:00 Blog

Rreth ndryshimeve te Kodit te Procedures Penale

13:47 Blog / 2 komente

[Armiqtë imagjinarë dhe shënjestra e prishur e opozitës](#)

11:30 Blog / 4 komente

["Lëvizja e studentëve" në Serbi dhe paralelet me "Revolucionin e Flamingove" në Shqipëri](#)

20:42 Blog / 30 komente



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.